



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 853/3 Prot

Tiranë, më 01. 6 .2021

VENDIM

Nr. 28 , datë 01 . 6 .2021

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Znj. \_\_\_\_\_ (në vijim “ankuesja”) ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) ankesën nr. 853 Prot., datë 05.05.2021, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik/Bashkia Këlcyrë (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesja, në cilësinë e kërkueses, nëpërmjet e-mail-it datë 14.04.2021, depozituar në adresën \_\_\_\_\_, ka kërkuar t'i vihet në dispozicion informacioni dhe dokumentacioni, mbi miratimin e zonave të mbrojtura dhe zonimin e brendshëm të tyre, sipas Vendimit nr. 10, datë 28.12.2020 të Këshillit Kombëtar të Territorit, konkretisht zonat, Lumi Vjosë dhe Zagorie. Bazuar në nenin 8, pika 3 dhe 4 e ligjit nr.81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, kërkohet:

1. Pëlqimi paraprak i kryetarit të Bashkisë Këlcyrë, lidhur me propozimin e ardhur për mënyrën e menaxhimit të zonës së mbrojtur Lumi Vjosë dhe Zagorie;
2. Çdo dokument apo qëndrim që ka mbajtur Bashkia Këlcyrë, lidhur me këtë proces.

Në mungesë të një përgjigje nga ana e Autoritetit Publik, me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesja ka paraqitur ankim pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjëndje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*”, Zyra e Komisionerit, me shkresën nr. 853/1 prot., datë 06.05.2021, ka kërkuar qëndrimin e Autoritetit Publik, në lidhje me pretendimin e ngritur nga ankuesja, si dhe sqarime në lidhje me disponimin e dokumentacionit të kërkuar.

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 1040 Prot., datë 18.05.2021 ka kthyer përgjigje duke sqaruar se: “*Parku Natyror “Zagoria” është shpallur me VKM nr. 354, datë 02.05.2018 dhe është në administrim të ADZM Gjirokastër. Pëlqimi paraprak për shpalljen Parku Rajonal Zagoria është dhënë nga ish Komuna Zagoria dhe janë bërë dëgjesa Publike. Për sa i përket zgjerimit të Parkut ku janë shtuar me VKM nr. 354, datë 02.05.2018, “Gryka e Këlcyrës dhe Gryka e Selkës” është zgjerimi ekzistues, ku në Bashkinë e Këlcyrës zë një sip. 3570 ha*”.

Ankuesja, pas përgjigjes së sipërcituar, ka vijuar ankimin me e-mail-in datë 20.05.2021, duke pretenduar se nuk ka marrë përgjigje sipas objektit të kërkesës për informacion, pasi pyetjet e bëra kanë lidhje me “*Vendimin Nr.10, dt. 28.12.2020 të Këshillit Kombëtar të Territorit, ku janë miratuar kufinj të rinj të zonave të mbrojtura dhe është bërë zonimi i brendshëm i tyre*”.

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës, parashtrimeve të paraqitura nga Autoriteti Publik dhe dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, Autoriteti Publik nuk ka përmbushur detyrimin për dhënien e informacionit/dokumentacionit të kërkuar sipas objektit të kërkesës për informacion.

Komisioneri vlerëson se, informacioni/dokumentacioni i kërkuar, përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2 të LDI, sipas të cilit “*Informacion publik konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik*”. Në këtë kuptim, Autoriteti Publik duhet të vendosë në dispozicion të kërkuarit çdo informacion/dokumentacion, i cili është prodhuar ose mbahet nga ky i fundit në formën e disponuar.

Bazuar në shkronjën a) të pikës 2 të nenit 10, të LDI, në të cilën parashikohet se, “*Koordinatori për të drejtën e informimit... a) i mundëson çdo kërkuar të drejtën për t’u njohur me informacionin publik, sipas këtij ligji, duke u konsultuar me dokumentacionin origjinal ose duke marrë një kopje të tij;*”.

Gjithashtu, pika 2, e nenit 12 të LDI përcakton: “*Në qoftë se pas shqyrtimit të kërkesës autoriteti publik konstaton se nuk e zotëron informacionin e kërkuar, ai, jo më vonë se 10*

*ditë kalendarike nga data e dorëzimit të kërkesës, ia dërgon atë autoritetit kompetent, duke e vënë në dijeni edhe kërkuuesin. Arsyeja e vetme që justifikon dërgimin e kërkesës një autoriteti tjetër është mungesa e informacionit të kërkuar”.*

Për sa më sipër, bazuar në nenin 1 të ligjit të sipërcituar, përcaktohet qartë se, *objekt i këtij ligji është çdo informacion që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. Në këtë kuptim, çdo autoritet publik pavarësisht nëse është në cilësinë e “prodhuesit” apo “mbajtësit” të informacionit, detyrohet të garantojë njohjen e publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit dhe të shoqërisë.*

LDI ka për qëllim të nxisë përf forcimin e integritetit, transparencës e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe çdo subjekti që ushtron funksione publike.

Detyrimi për bërjen transparente të veprimtarisë së tyre, njësisive të qeverisjes vendore i u lind gjithashtu edhe në zbatim të Kreut VI, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Konkretisht në nenin 15 të ligjit të sipërcituar “Transparenca e veprimtarisë së njësisive të vetëqeverisjes vendore”, parashikohet se: *“1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre. 2. Çdo akt i organeve të vetëqeverisjes vendore publikohet në faqen zyrtare të internetit të njësisë vendore dhe afishohet në vendet e caktuara nga njësia për njoftimet publike...”.*

Në pikën 3 të nenit 3 të ligjit për të drejtën e informimit parashikohet se: *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.*

Bazuar në nenin 15 të po këtij ligji, *“autoriteti publik trajton kërkesën për informim brenda 10 ditëve pune nga data e dorëzimit të saj”.*

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funkzionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e znj. \_\_\_\_\_ ndaj Autoritetit Publik/Bashkia Këlcyrë, Komisioneri vlerëson se, duke pasur parasysh sa është parashtruar më sipër, ankimi është bazuar në ligj dhe si i tillë duhet pranuar.

## **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

## VENDOSA:

1. Pranimin e ankesës nr. 853 Prot., datë 05.05.2021 të znj. \_\_\_\_\_, kundër Autoritetit Publik “Bashkia Këlcyrë”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të informacionit/ dokumentacionit të kërkuar sipas kërkesës për informacion të datës 14.04.2021 (1.Pëlqimi paraprak i kryetarit të Bashkisë Këlcyrë, lidhur me propozimin e ardhur për mënyrën e menaxhimit të zonës së mbrojtur Lumi Vjosë dhe Zagorie; 2.Çdo dokument apo qëndrim që ka mbajtur Bashkia Këlcyrë, lidhur me këtë proces), brenda datës 08. 6 .2021.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 01 . 6 .2021.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

